

AKTI I THEMELIMIT

i

SHOQERISE TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " UNIVERS " SH.P.K.BURREL.

Ne Burrel, sot me daten 22 janar 1996 ne te nenshkruarit Rustem Nuzi i biri i Hadarit dhe i Hankes i datelindjes 1966, me banim ne lagjen Pjeter Budi te qytetit Burrel dhe Hasan Totraku i biri i Aliut dhe i Shkurtes i datelindjes 1960, me banim ne lagjen Pjeter Budi te qytetit Burrel, me cilesine e Ortakeve themelues, me vullnetin tone te lire, vendosem te krijojme shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar " Univers " Sh.P.K.Burrel.

H Y R J E

Ne kuptimin e ketij akti themelues, ortaket Rustem Nuzi dhe Hasan Totraku, jane themeluesit e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers "Sh.p.k.Burrel. Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers"Sh.p.k. me qender ne qytetin e Burrelit dhe me shtrirje ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria tregtare private "Univers" Sh.p.k.Burrel rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me aktin e themelimit, statutin e saj, me ligjin nr.7512 date, 10 gusht 1991, kodin tregtar, ligjin nr.7638 date, 19.11.1992 dhe aktet e tjera te legjislacionit shqiptar.

Objekti i veprimtarise private i kesaj shoqerie do te jete: Studim, projektim e zbatim ne fushen e ndertimeve civile e industriale, prodhim i materialeve te ndertimit dhe ne fushen e energjitikes, import eksport e tregetim te artikujve industrial, makineri e paisje, pjese kembimi, perpunim dhe tregetim dhe eksport te lendes drusore, transport mallera e pasagjer etj.

AFATI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e shoqerise do te jete efektive qe nga dita e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane si dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organet kopetente.

Aktiviteti privat i kesaj shoqerie do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i kesaj shoqerie perbehet nga shuma prej 100000 leke te arketuara ne Banken tregtare Burrel, shume e cila eshte derdhu: ne pjese te barabart nga te dy ortaket themelues nga 50000 lek secili

Ortaket themelues ose persona te autorizuar prej tyre kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve periodike ose vjetore te perfit



jne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shtetore, sigurimet shoqerore etj. Per shkelje te ndryshme e te mundeshme te parashikuara ne statut, ortaket themelues mund te marrin masa ndeshkimore ndaj kujtedo qe demton pasurine e shoqerise.


JURIDIKSIONI

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "Univers2 sh.p.k. Burrel e ka qendren e saj ne lagjen "Ejeter Budi" te qytetit Burrel. Te gjitha mosmarreshjet me personat juridik e financiar, vendas e te huaj si dhe me organet shtetore, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten zgjidhja e tyre mund te behet konflikt ne Gjykatën e rrethit Tirane.

Ortaket Themelues

RUSTEM NUZI

HASAN TOTRAKU



Ky akt themelimi u

regadit nga une

Avokati

(Hajredin Hysa)



AVOKAT,
Hajredin Hysa
MAT

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Notere Vjollca Skendo


Nr. 202 Rep.

Nr. 101 Kol.

V e r t e t i m

Ne Tirane sot me daten 16. 01 1996, perpara meje noteres Vjollca Skendo u paraqiten personalisht shtetasit Rustem Hajdar Nuzi dhe Hasan Ali Totraku me banim ne lagjen "Ejeter Budi" te qytetit Burrel per identifikimin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet me nr. 482422 dhe 482413, madhor dhe me zotesi per te vepruar te cilet me sollen per vertetim aktin e themelimit te hartuar jashte kesaj zyre dhe deklaruan se akti eshte bere sipas vullnetit te lire te tyre dhe se nenshkrimi eshte i tyre, ndaj une noterja e vertetoi ate rregullisht ne baze te ligjes.

Notere
(Vjollca Skendo)



STATUTI

1

"SHOQERISE TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR"Univers" SH.P.K.BURREL.



Ne baze te ligjit Nr.7512 date,10 gusht 1991 "Per bashkimin dhe mbrojtjen e prodhe private,names se lire,vaprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" te kodit tregtar sh-aktive te tjera ligjore, ne burrel sot ne date 22 janar 1995 ne ortaket Rustem Hajdar Nuzi dhe Hasan Ali Totraku me barim te lagjes "Fleter Badi" te qytetit Burrel, me vullnetin tone te lire dhe te plote,ne perputojme ne legjislicionin shoqer veqosem qe te krijojme shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers" Sh.p.k.Burrel.

ARTIKULLI I DESIQZETA E KUFIZIMIT

neni 1

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "Univers"Shp.k Burrel eshte person juridik i pavarur,ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijeve te peshkulluar ne ligjin nr.7512 date 10 gusht 1991,kodit tregtar dhe aktive te tjera ligjore.

neni 2

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers"Sh.p.k.Burrel e ushtron vaprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut.

neni 3

Ortaket themelues te kesaj shoqerie ne kete sipermarrje kane derdh kapitalin e tyre ne pjese te barabarta nga 20000 leke shtetli,me qellim qe te perfutojne te arsimuar qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballojne humbjet decel ne kufirin e vleres se kontributit fillestar.

neni 4

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers"Sh.p.k.Burrel eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vapruar me rregjistrimi e saj ne Gjykatën e rrethit Tiranë dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.

NESETI-GJENDJE-TERRITORI

neni 5

Emertimi i shoqerise do te jete : Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers"Sh.p.k.Burrel.

neni 6

Selia e kesaj shoqerie do te jete ne lagjen "Fleter Badi"te qytetit Burrel.Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te çele filialet ne te gjithe teritorine e Republikës se Shqiperise.

O B J E K T I

Neni 7

Objekti i veprimtarise dhe aktiviteti i kesaj shoqerie private do te jete :

Studim, projektim e zbatim ne fushen e ndertimeve civile e industriale, prodhimit te materialeve te ndertimit dhe ne fushen energjitike, import eksport e tregetim te artikujve industrial, makineri e pajise dhe eksport lende drusore, transport malleresh e pasagjere etj.

si dhe çdo aktivitet tjeter qe veçmas ose se bashku me ato te përmendura me sipër do te konsiderohen te pershtateshme per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.

AFRITI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti tregetar i shoqerise do te zhvillohet me nje afat te paktuar mbi 10 vjet.

Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos e ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike e financiare brenda dy vjetesh mund te behet me lejen e organeve kompetente shtet-
rore perkatese.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themelor i shoqerise tregtare private "Univers" sh.p.k. Burrel perbehet nga shuma prej 100000 leke, shume e cila eshte derdhur ne menyre te barabart nga te dy ortakët themelues nga 50000 leke.

Neni 11

Trasferimet e kapitalit themelor duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sapa ti behen te ditura asaj.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themelor jane te transferueshme ne rruge trashgimje. Ato mund tu kalojne bashkeshortëve, paraardhesve dhe pasardhesve.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 13

Shoqeria private me pergjegjesi te kufizuar "Univers" Sh.p.K. Burrel me ortak Rustem Nuzi dhe Hasan Totraku do te kete si administrator z. Rustem Nuzi. ortakët themelues kane te drejte te caktojne si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk jane ne cilesine e ortakut



Neni 14

Ortakët themelues Rustem Nuzi dhe Hasan Totraku kanë në kompetencë :

- të miratojnë programin e shoqërisë, të hartojnë raportin e administrimit të inventarit, llogarit vjetore të cilat hartohen brenda një afati 6 - muaj duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.
- vendos për shpërberjen e shoqërisë.
- vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- rregullon marrëdhëniet e punësimit e të shpërblimit brenda shoqërisë

Sipas afateve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shtetërore, personave juridik, vendas e të huaj e të tjera.

K R E U I I I

Neni 15

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Univers" Sh.p.k. Burrel, mund të lidh kontrata me sektor shtetëror drejtpërdrejtë me tregun e lirë si dhe me persona juridik e fizik, vendas e të huaj sipa legjislativës në fuqi për eksport import.

Neni 16

Në veprimet kontraktuale, kjo shoqëri përfaqësohet nga ortakët themelues ose persona të tjerë të autorizuar prej tyre.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë dhe punonjësit e saj.

Neni 18

Sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve të tjera ligjore, shoqëria përgjigjet për kontabilitetin fiskal, afatet e derdhjes së detyrimeve ndaj shoqërisë, sigurimet shoqërore etj.

Sipas ligjeve të tatimit mbi fitimin përcaktohen tatimet për veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë të çel llogarit pranë bankave të vendit e të huaja në shqipëri dhe të kryej veprimet e likuidimit ndërmjet tyre.

Neni 19

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike kjo shoqëri ka të drejtë të vetfinansohet në leke ose valute të huaj.


Neni 20

Shkëmbimin e monedhës shqiptare në monedhe të huaj e anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga banka e shtetit shqiptar ose me tregun e lirë të valutes.

Neni 21

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve të caktuara vet shoqëria. Çmimet dhe tarifat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertës.

Neni 22



Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar ortaket themelues, ose persona te tjere te caktuar prej tyre jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas ligjit te vecant

K R E U I III

MARREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 23

Ortaket themelues per realizimin e veprimtarise se tyre marrin ne punonjes me kontrate pune vjetore dhe sezonale. Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates se lidhur lirisht midis paleve.

Neni 24

Punonjesit gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas kodit te punes se Republikes se Shqiperise.

Neni 25

Adryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Ortaket themelues z. Rustem Nuzi e Hasan Totraku. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vet kerkesen e te interesuarit.

K R E U I IV

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 26

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore etj u kalojne ne pronesi ortakeve themelues dhe ndahen sipas kontributit te sejcilit.

Neni 27

Shperblimi per personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise private "Univers" Sh.p.k. Burrel caktohen sipas kontrates se punes. Adryshimi ne page vendoset nga ortaket themelues.

K R E U I V

Dispozita te Fundit

Neni 28

Ortaket themelues me rastin e shtimit te numerit te ortakeve kane te drejte te bejne ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartojne edhe kontraten e perbashket me ortake te tjere duke bere ndryshimet e nevojshme ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

Neni 29

Marredheniet e shoqerise tregtare "Univers" Sh.p.k. Burrel ne marredhenie me persona juridik e fizik, vendas dhe te huaj zgjidhen me mirekuptim dhe kur ky nuk arrihet, zgjidhen nga gjykata e rrethit Tiranes.



= 5 =

Neni 30

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit me nr.7512,date,10 gusht 1991,kodit tregtar te Republikes se Shqiperi si dhe çdo akti tjeter ligjor te legjislacionit shqiptar.

Neni 31

Statuti perpilohet ne disa kopje per tiju derguar organeve kompetente.Nje kopje e tij mbetet si pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Univers"Sh.p.K. Burrel.

U nenshkrua ne Burrel sot me date,22 janar 1996.

ORTAKET THEMELUES

RUSTEM NUZI

HASAN TOTRAKU

Ky statut u pregadit nga une, A v o k a t i

(Hajredin Hysa)

AVOKAT
Hajredin Hysa
MAT

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Notere Vjollca Skendo

Nr. 294 Rep.

Nr. 102 Kol.

V e r t e t i m

Ne Tirane,sot me daten, 26.01 1996,perpara meje notere Vjollca Skendo u paraqiten personalisht shtetasit Rustem Hajdar Nuzi dhe Hasan Ali Totraku me banim ne qytetin e Burrelit,per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njohjetimet e tyre me numer 482422 dhe 482413,medhor e me zotesi per te vepruar,te cilet me sollen per vertetim statutin e shoqerise tregtare"Univers"te hartua jashte kesaj zyre dhe deklaruan se akti snpreh deshiren e tyre dhe eshte nenshkruar me vullnetin e tyre te lire e te plots,ndaj une, noterja e vertetoi ate ne baze te ligjes.

Not
(Vjollca Skendo)

